

RAPORTI JO TEKNIK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE AKTIVITETIT:

“ Repart Prodhimi, perpunimi dhe shitje produktesh metalike per eksport”

VENDODHJA: XHAFZOTAJ, DURRES

INVESTITORI: ITAL METALBA SRL SHPK

HARTOI RAPORTIN: LUMTOR SHKRELI (EKSPERT MJEDISI)



PERMBAJTJA

| | |
|---|----|
| HYRJE | 3 |
| SHPJEGIMI I AKRONIMEVE | 4 |
| 1. OBJEKTIVAT E VLERESIMIT TE IMPAKTIT MJEDISOR | 6 |
| 1.1 Objektivat kryesore të VNM-së janë si më poshtë: | 6 |
| 2. INFORMACION BAZE | 7 |
| 3. PERSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK..... | 8 |
| 4. ASPEKTET MJEDISORE TE SUBJEKTIT..... | 14 |
| 4.1 Shkarkimet ne ujra | 14 |
| 4.2 Ndotja e tokes..... | 14 |
| 4.3 Ndotja e ajrit..... | 14 |
| 4.4 Ndikimet nga zhurmat dhe vibracionet..... | 15 |
| 5.5 Ndikimi ne mjedisin social..... | 15 |
| 5.7 Nivelet dhe ndikimet e emetimeve nga zhvillimi I projektit gjate fazes normale te operimit..... | 15 |
| 5.8 9. Ndikimet e projektit ne rruget lokale dhe te transportit..... | 15 |
| 5.9 Ndikimi i projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi veprat e tjera njerëzore | 15 |
| 1. Masat per ndikimet nga zhurmat | 16 |
| 2. Masat per ndikimet ne ajer | 16 |
| 3. Masat per ndikime ne toke | 16 |
| 4. Masat per ndikimet ne ujera..... | 16 |
| 5. Masat per menaxhimin e mbetjeve..... | 16 |
| 6. Sistemet Elektrike | 17 |
| 5.11 Monitorimi dhe Respektimit i Parametrave | 17 |
| 5. PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR | 18 |
| 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME..... | 19 |

HYRJE

Ligji i Vlerësimit të ndikimit mjedisor Nr. 10 440 datë 07.07.2011 mbi " Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor " në Shqipëri thekson për përgatitjen e vlerësimeve mjedisore të çdo projekti të zhvillimit që mund të shkaktojë ndikime në mjedisin e vendit.

Ky raport VNM-je është përgatitur sipas kërkesave kombëtare të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit të përmendura me poshtë si dhe sipas legjislacionit të BE-së marrë si referencë. Legjislacioni Kombëtar i Shqipërisë përcakton rregullat dhe mënyrat për kryerjen e një VNM-je të kësaj natyre, të cilat konsulentët i kanë konfirmuar. Ligji ka theksuar për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe burimet e tij duke e konsideruar atë si pjesë e trashëgimisë kombëtare e cila duhet të ruhet dhe të mbrohet për të mirën e gjeneratave të ardhshme. Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve të tij është një pararendës kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Ky raport VNM-je do të identifikojë ndikimet e mundshme në mjedis të proceseve të punës për " Repart Prodhimi, perpunimi dhe shitje produktesh metalike per eksport " , me theks të veçantë në rekomandimet mbi zvogëlimin e ndikimit dhe marrjen e masave të nevojshme për të minimizuar ndikimet që mund të lindin gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe pas përfundimit të tij. Raporti i VNM-së do të diskutojë gjithashtu mbi justifikueshmerine e projektit, alternativat e vendosjes së komponentëve të projektit të tilla si planet e projektit dhe konsideratat mjedisore. Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen .

Raporti paraprak i vleresimit te ndikimit në mjedis do te paraqese nga njera ane rendesine e zbatimit te projektit " Repart Prodhimi, perpunimi dhe shitje produktesh metalike per eksport " përshkrimin e këtij projekti dhe nga ana tjetër ndikimet negative kryesore në mjedis, masat zbutese për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundshme këto ndikime negative, duke llogaritur se si qëndron ekuilibri ndërmejt tyre për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Të paraqesë realizimin e ketij projekti dhe zhvillimin ekonomik që përfitohet prej zbatimit të tij, por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin "e zhvillimit të qëndrueshëm". Ky dokument prezanton gjithashtu dhe palët qe marrin pjesë, përfitojnë apo preken nga zbatimi i tij.

SHPJEGIMI I AKRONIMEVE

- **“Cilësi e mjedisit”** është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.
- **“Dëmtim i mjedisit”** është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.
- **“Kapacitet bartës”** është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, vetitë e tij natyrore.
- **“Mjedis”** janë përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.
- **“Mjedis i kërcënuar”** është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnisë së një ndotjeje të konsiderueshme.
- **“Ndërhyrje negative në mjedis”** është çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut, që mund të prekë kapacitetin bartës të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose që ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin.
- **“Ndotje”** është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimit e tjera të ligjshme të mjedisit.
- **“Subjekt ndotës ose ndotës”** është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit.
- **“Substancë e rrezikshme”** është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t'u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.
- **“Shkarkim”** është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.
- **“Gjendje e pranueshme e mjedisit”** është gjendja në të cilën mjedisi i vendit në fjalë ishte para se instalimi të vihej në operim. Arritja e kësaj gjendjeje kërkon masa që përfshijnë, por nuk kufizohen me: largimin e të gjitha mbetjeve që kanë tepruar, largimin sa më shumë të jetë e mundur të çdo lloj ndotjeje, dhe, aty ku ky largim nuk do të thotë trajtim praktik apo stabilizim i ndotjes, rehabilitimin e çdo dëmi që mund të ketë shkaktuar ndotja, si dhe zbutjen e efekteve të çdo dëmi.
- **“Instalim”** është çdo njësi teknike e palëvizshme, që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie që lidhet drejtpërdrejt me të apo ka një lidhje teknike me veprimtarinë e zhvilluar në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;
- **“Instalim ekzistues”** është: a) një instalim që është në funksionim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) një instalim që nuk është vënë ende në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi, por për të cilin është dhënë leja e ndërtimit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 119 datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, dhe ndërtimi i të cilit fillon brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- **“Instalim i ri”** është: a) një instalim që nuk është instalim ekzistues; b) një instalim ekzistues, për funksionimin e të cilit operatori nuk ka kërkuar pajisjen me lejen përkatëse të mjedisit, brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj. Në këtë rast, ky instalim trajtohet si një instalim i ri.
- **“Normat e cilësisë së mjedisit”** është një grup kushtesh që duhen përmbushur në një kohë të dhënë nga një mjedis i caktuar ose një pjesë e veçantë e tij, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- **“Substancë”** është çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive dhe të organizmave të modifikuar gjenetikisht, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- **“Shkarkim në ujë”** janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të zeza e të bardha.

- **“Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)”** është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundur, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.
- **“Biomasa”** është produkt i përbërë, tërësisht ose pjesërisht, nga material bimor nga bujqësia ose pemëtaria, që mund të përdoret si lëndë djegëse, me qëllim rikuperimin e energjisë së përmbajtur në të.
- **“Vlera kufi e shkarkimit”** është sasia e lejueshme e një substance në masën e gaztë të shkarkuar në ajër nga instalimi me djegie, gjatë një periudhe të dhënë. Sasia e substancës llogaritet në terma të masës/për vëllim të gazeve të shkarkuara, të shprehura në mg/Nm³, duke konsideruar një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara: prej 3 për qind, në rastin e karburanteve të lëngshme e të gazta, 6 për qind në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 për qind në rastin e turbinave me gaz.
- **“Projekt”** është:
 - zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;
 - ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve.
- **“Zhvillues”** është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik.
- **“Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)”** është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.
- **“Publiku”** ka kuptimin që jepet në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- **“Publik i ndikuar”** është publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore që shprehin interes.
- **“Vendim”** është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin është vendosur nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t’i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.
- **“Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis”**, më poshtë “Deklarata mjedisore”, është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri, për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar dhe që përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës që i bashkëlidhet ligjit Nr.. 10 081, date 23.2.2009 “Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë”.
- **“Vlerësim ndërkuftar i ndikimeve në mjedis”** është procesi i VNM-së, që zhvillohet për projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara (ESPOO) “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar”, që, bazuar nga vendndodhja a teknologjia e tyre, mund të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e shteteve fqinje apo të vendit tonë.

1. OBJEKTIVAT E VLERESIMIT TE IMPAKTIT MJEDISOR

1.1 Objektivat kryesore të VNM-së janë si më poshtë:

- Të kryhet vlerësimi i ndryshimeve mjedisore që mund të kenë ndodhur pas 3 viteve të para të funksionimit të fabrikës së çimentos, si rezultat i funksionimit dhe çmontimit të fabrikës, objektiva këto të vëna që në konturimin fillestar të projektit;
- Të përcaktohen ligjet dhe rregulloret kombëtare si dhe standardet mjedisore sipas Bashkimit Evropian (BE) (p.sh. BAT BREF (Teknikat më të mira të disponueshme), sipas BE)
- Vlerësimi i përputhshmërisë me kërkesat e e legjislacionit Shqiptar si dhe me kushtet e lejuara mjedisore;
- Vlerësimi i performancës së kompanisë si dhe identifikimi i zonave të cilat kanë nevojë të përmirësohen;
- Vlerësimi i masave të propozuara që në fillim të zhvillimit të aktivitetit të kompanise me qëllim eliminimin e ndikimeve negative në mjedis dhe kontrolli i efikasitetit të zbatimit të tyre;

Si rezultat, studimi do të fokusohet në:

- Cilësinë e Ajrit
- Energjinë dhe Balancën e Gazeve Serë
- Karakteristikat e Tokës
- Cilësinë e ujërave nëntokësore
- Cilësinë e Ujërave Sipërfaqësore dhe të Shkarkimeve
- Pejzazhi dhe Impakti Vizual
- Pamja e përgjithëshme
- Flora dhe Fauna
- Uji
- Niveli i Zhurmave
- Antikiteti dhe zona të tjera me rëndësi Historike dhe Kulturore
- Infrastruktura Ekzistuese e Transportit dhe rrjedha e Trafikut
- Infrastruktura ekzistuese e shërbimeve komunale dhe përdorimi i tyre

2. INFORMACION BAZE

Në këtë raport paraqitet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetin “Repart Prodhimi, perpunimi dhe shitje produktesh metalike per eksport”. Objekti ndodhet ne toke private te shoqerise XHILI 2003 shpk ne Xhafzotaj, Durres, e marre me qera nga shoqeria ITAL METALBA SRL shpk (Kontrata e qerese bashkelidhur).

| NR | KOORDINATAT | |
|----|-------------|------------|
| | LAT | LON |
| 1 | 4374722.7 | 4580381.08 |
| 2 | 4374686.08 | 4580376.05 |
| 3 | 4374829.91 | 4580165.9 |
| 4 | 4374862.71 | 4580176.41 |

Siperfaqja totale **10291 m²**

Siperfaqe ndertese **5081.8 m²**

Kapaciteti prodhues **1000 ton/vit**



3. PERSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK

Pajisjet te cilat do te perdoren gjate funksionimit te ketij aktiviteti per perpunimin dhe prodhimin e produkteve metalike per eksport jane:

1. Linje prerje metalike
2. Linje profilimi
3. Saldatrice
4. Sharre shirit
5. Sharre disk
6. Tripan kollone
7. Puntatrice
8. Ambalazhues

Linja e prerjes se profileve metalike eshte nje linje e cila perdoret per prerjen e shufrave metalike me gjeresi te ndryshme duke qene se do prodhohen profile te ndryshme metalike qe do te sherbejne si platforma te tubacioneve te gazit. Lenda e pare (profilet metalike) vijne nga Italia dhe i nenshtrohen perpunimit dhe prodhimit ne repartin tone .

Linja e profilimit eshte nje linje e cila prodhon profile te gjereseve, trashesive dhe formave te ndryshme.

Saldatricet sherbejne per bashkimin e dy elementeve te ndare, ku me ane te procesit te saldimit ato lidhen.

Sharra shirit sherben per prerjen e elementeve metalik sipas gjatesise se kerkuar nga klienti duke qene se profilet behen me gjatesi standarte.

Sharra disk sherben per prerjen e paneleve te cilet nuk jane prodhim i subjektit "J-coils".

Tripanet sherbejne per hapjen e vrimave ne element te ndryshem me nje diameter D.


Puntatricet sherbejne per bashkimin e dy pjeseve metalike me nxehtesi.

Produktet e saj kryesore jane :

- o Perpunim dhe prodhim i profileve dhe shufrave metalike qe vijne nga jashte si: prerje, çpim, tornim, frezim, montim, saldimit dhe shitje per eksport .
- o Prodhim i konstruksioneve metalike per platforma gazi.



PLANIMETRIA E KAPANONIT 2
SH. 1: 200



QKBYT
ZEMRINDRITIA E PLANIT
Në Dhomën e Juriut të Komitit të
Kryeqytarëve të Bashkisë së
Kryeqytetit të Tiranës
Nr. 100/2018
10.05.2018

PLANIMETRIA E KAPANONIT 2
SH. 1: 200
ANB JUS/AM
10.05.2018

PLANIMETRIA E KAPANONIT 2
SH. 1: 200
ANB JUS/AM
10.05.2018

Sipërfaqja e kapanonit = 2383,76M²

4. ASPEKTET MJEDISORE TE SUBJEKTIT

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem. Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe linjes teknologjike. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoje te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- Njohja me proceset e punës
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do zhvillohet aktiviteti

Ndikimet e pritshme ne mjedis te analizuara gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permblidhen si me poshte:

4.1 Shkarkimet ne ujra

Burimet e gjenerimit te shkarkimeve ne ujra vijne nga:

- Pastrimi i ambjenteve te aktivitetit
- Ujerat e perdorura per qellime sanitare

Lidhur me ujrën qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk duhet te perzihen me ujrën industriale, por duhet te kalojne ne sistem kanalizimi dhe te lidhen me kolektorin e zones. Duke respektuar procesin teknologjik, mundesite e ndotjes nga ujerat e shkarkimit do te jene zero.

4.2 Ndotja e tokes

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk kemi ndikime ne toke. Procesi i prodhimit dhe perpunimit te produkteve metalike kryhet ne te thate, dhe me terheqje ne te ftohte pa perdorur energji elektrike. Nga ky aktivitet gjenerohet nje sasi mbetjesh metalesh dhe vajrash, te cilat subjekti do ti largoje me nenkontraktore ne vendgrumbullimet e asgjesimit perfundimtar te tyre.

Per te evituar ndotjen e tokes, mbetjet metalike qe do gjenerohen gjate procesit do te grumbullohen ne vende te caktuara (vendgrumbullimi do jete i izoluar ne menyre qe te shmanget ndotja e tokes), dhe me pas do behet largimi me nenkontraktore te licensuar.

4.3 Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit mund te vije gjate levizjes se automjeteve, te cilat furnizojne subjektin me lende te pare dhe nga automjetet te cilat marrin produktet perfundimtare te cilat do te prodhohen ne kete kompani.

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emetohen do te jene vazhdimisht Brenda normave te lejuara, do te merren keto masa nga ana e subjektit:

- a. Levizjet e mjeteve ne kapanon do te behet duke respektuar nje shpejtesi te ulet te levizjes, me qellim shmangien e emetimit te pluhurave ne ajer.
- b. Te gjitha rruget perreth repartit jane te shtruara me asphalt, gje e cila ben te mundur shmangien e emetimeve te pluhurave ne ajer.
- c. Do behet lagia e shesheve me uje here pas here, ne menyre qe most e kemi ngritje te pluhurit ne ajer

- d. Do të kufizohet shpejtësia e lëvizjes së mjeteve, deri në 30 km/orë; Gjithashtu edhe kur është trafik i renduar nese do te kete ne dite te vecanta.
- e. Do të vendosen mbulesa mbrojtëse për mbetjet e ekspozuara ndaj erës;

4.4 Ndikimet nga zhurmat dhe vibracionet

Zhurmat që prodhohen në këto aktivitete vijnë kryesisht nga makinerite prerese, dhe makinerite dhe mjetet e tjera. Procesi i perpunimit dhe prodhimit të profileve metalike shoqërohet me cilrim zhurme, por theksojmë se ky nivel emetimi zhurmash mbeten brenda ambientit të punës, dhe nuk shqetësojnë zonën përreth. Punonjësit që do të punojnë në këto aktivitete, vazhdimisht do të përdorin pajisje mbrojtëse.

Në zonën e aktivitetit, subjekti do të hartojë dhe zbatojë programin e masave për mbrojtjen nga zhurmat si më poshtë:

- a. Do të respektohen standardet për nivelin e zhurmave
- b. Aktivitetet e punës do të kufizohen në orët që sjellin shqetësime për banorët përreth
- c. Makineritë e pajisjet, si dhe ato që gjenerojnë zhurmë mbi kufijtë e lejuar do të izolohen me xham mbrojtës për zhurmat.

5.5 Ndikimi në mjedisin social

Aktiviteti i subjektit ka një impakt pozitiv në mjedisin social, pasi krijohen vende të reja pune për banorët e zonës.

5.6 Ndikimet e projektit në zonat rrethuese dhe pejzazh

Duke qenë se kemi të bëjmë me një godinë ekzistuese, projekti nuk ka ndikime negative në zonën rrethuese. Zbatimi i projektit nuk ndryshon konfigurimin, topografinë e zonës dhe peisazhin e saj. Prandaj nuk do të ketë nevojë për reabilitime të dukshme.

5.7 Nivelet dhe ndikimet e emetimeve nga zhvillimi I projektit gjatë fazes normale të operimit

Gjatë fazes normale të zbatimit të projektit, bazuar në teknologjinë e përdorur nuk do të ketë emetime të gazeve, lengjeve, mbetjeve të ngurta toksike dhe lende të tjera të demshme që mund të shkarkohen në ajër dhe në tokë, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e puntoreve, banorëve përreth, mjedisin floranë dhe faunën e zonës.

5.8.9. Ndikimet e projektit në rruget lokale dhe të transportit

Makinat e furnizimit me lende të parë të materialeve nuk do të ketë ndikim të dukshëm në rruget lokale për faktin se ky subjekt do të ketë një numër shumë të kufizuar mjeteve në punë. Kështu zhvillimi i projektit nuk do të ketë ndikime të dukshme në rruget lokale dhe nacionale të transportit. Zona në fjalë nuk ka trafik të renduar që të ndalojë kufizimi i mjeteve të punës në kantier gjatë orëve të ndryshme të ditës, pasi vetë zona është një zonë rurale.

5.9 Ndikimi i projektit mbi ndertimet, trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi veprat e tjera njerëzore

Nga zbatimi i projektit nuk ka dhe nuk do të ketë impakt negativ mbi ndertimet, trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerëzore, sepse në këto zone dhe përreth saj, nuk ka objekte të kësaj natyre ose të një rëndësie të vacante të karakterit të mesiperm.

5.10 Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese. Kërkesat mjedisore që synojnë mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit, përfshijnë specifikimin e kushteve, normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastertise së ajrit urban, të ujerave sipërfaqesore e nëntokesore, të cilësive e vlerave të tokës, të territoreve urbane, rrugëve, trotuareve, zonave të gjelberuara. Drejtues të subjektit i cili do të vihet në shfrytëzim, do të marrin në konsideratë të gjitha masat lehtësuese zbutëse për ndikimet në mjedis.

1. Masat për ndikimet nga zhurmat

Në zonën e aktivitetit, subjekti do të hartojë dhe zbatojë programin e masave për mbrojtjen nga zhurmat, si më poshtë:

- a. Do të respektohen standardet për nivelin e zhurmave;
- b. Aktivitetet e punës do të kufizohen në orët që sjellin shqetësime për banorët përreth;
- c. Makineritë e pajisjet, si dhe ato që gjenerojnë zhurmë mbi kufijtë e lejuar, do të jenë të pajisura me ekrane mbrojtëse për zhurmat.

2. Masat për ndikimet në ajër

Me qëllim që shkarkimet në ajër që emetohen do të jenë vazhdimisht brenda normave të lejuara, subjekti, do të marrë marrin këto masa:

- a. Për lëvizjen e mjeteve në kaponon do të respektohet një shpejtësi e ulët e lëvizjes së mjeteve me qëllim shmangien e emetimit të pluhurave në ajër.
- b. Të gjitha rruget përreth repartit të prodhimit janë të shtrura me asfalt me qëllim shmangien e emetimit të pluhurave në ajër.
- c. Të gjitha ngarkesat të sigurohen nëpërmjet rregullimit, lagës ose mjete të tjera për të parandaluar derdhjet, rrjedhjet dhe pluhurat;
- d. Do të kufizohet shpejtësia e lëvizjes së mjeteve, deri në 30 km/orë; Gjithashtu edhe kur është trafik i rënduar nëse do të ketë në ditë të vecanta.
- e. Do të vendosen mbulesa mbrojtëse për mbeturinat e ekspozuara ndaj erës;

3. Masat për ndikime në toke

Nuk do të kemi ndikime në toke, pasi ska shkarkime të mbetjeve në toke. Mbetjet e metaleve që do të gjenerohen do të dergohen nga drejtues të shoqërisë në asgjësimin përfundimtar të tyre. Mbetjet urbane e gjeneruara nga stafi i punonjësve do të dergohen për në vendet e përcaktuara nga pushteti lokal.

4. Masat për ndikimet në ujera

Nuk do të ketë ndikime negative në ujera.

5. Masat për menaxhimin e mbetjeve

Subjekti nuk gjeneron mbetje të rrezikshme. Mbetjet metalike dhe vajrat që do të mbeten do të asgjësohen nëpërmjet një kompanie të licensuar të nenkontraktuar.

6. Sistemet Elektrike

Ne sistemin elektrik duhen zgjedhur materiale, pajisjet, fiksuesit, llambat te cilat duhet te jene sa me eficente persa i perket perdorimit te energjise me eficence si dhe te mos kemi nderhyrje te ekspozuara dhe te padeshirueshme te fushave elektromagnetike.

5.11 Monitorimi dhe Respektimit i Parametrave

Kryerja e monitorimit gjate procesit te punes synon vecanerisht te respektoje te gjitha normat e shkarkimeve ne ajer, uje dhe toke, duke bere monitorim sipas nje grafiku te percaktuar.

5.12 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm

5.13 Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë fazes se funksionimit te tij .
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit , në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

5. PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR

PMM-ja për një komponent Projekti apo një nënprojekt do të përmbajë:

- Vlerësimin e impakteve mjedisore të parashikuara në faza të ndryshme, veçanërisht gjatë funksionimit (përfshirë mirëmbajtjen) dhe dekomisionimit, periudhat kohore gjatë të cilave do të kryen fazat e mësipërme, shkallën e tyre, qëllimin dhe pasoja(t).
- Përcaktimin e nivelit të pranueshëm të secilit impakt, veçanërisht në lidhje me periudhën kohore, zgjatjen në kohë, shkallën, pasojën (t), koston (t), dhe nivelet e lejuara ligjore.
- Kushtet dhe masat që duhen ndërmarrë për të zbutur këto impakte që ka mundësi të dalin në çdo fazë, cilët do të jenë përgjegjës për to, nëse duhet përmirësuar projekti teknik, ose nëpërmjet masave mbrojtëse gjatë funksionimit, apo metoda të tjera, kostot e mundshme, implikimet për përfundimet e projektit, etj.
- Burimet dhe metodat e kërkuara për monitorimin, matjen dhe vënien në zbatim të tyre (çfarë është për t'u matur, kur dhe ku, nga kush dhe pse); përgjegjësitë institucionale për secilin veprim; dhe kërkesat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve, dhe kostot përkatëse të secilit element.
- PMM-ja do të përmbajë dy dokumente të veçanta: një Plan Zbutës, që merret me aspektet e përshkruara më sipër, dhe një Plan Monitorues që merret me aspektet e përshkruara më sipër. Pritet që të përgatiten në kohën e finalizimit të përfundimit të projektit teknik dhe duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e specifikuar në Vendimin Paraprak të VNM-së të lëshuar nga AKM-ja.
- NJQV-ja ose propozuesit (nëse nuk janë të njëjtë) do të jenë përgjegjës për përgatitjen e PMM-së. Megjithatë në Termat e Referencës së projektuesit të projektit përfshihet përgatitja e PMM. Aty ku nënprojekti kërkon një VNM, do të kërkohet mendimi i specialistëve të VNM para se ky i fundit të finalizohet .

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Perfundime dhe Rekomandime:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i gjeneratorit dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane .
- Të vendosen postera sensibilizues për punonjësit dhe banorët për një mjedis të pastër.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat e përcaktuara në këtë raport të VNM.
- Subjekti të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset dhe të ndërtohen shkallët e emergjencës.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Ndikimet do të jenë kryesisht të përkohshme dhe jo të përhershme
- Për ndikimet e identifikuar janë propozuar masat përkatëse me qëllim minimizimin dhe eliminimin e këtyre impakteve
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.

Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille).

- Nuk do të ketë ndikime nderkufitare pasi projekti do të zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Hartoi Reportin e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis :

Ekspert Mjedis

Lumtor Shkreli

